



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
РЕПУБЛИКА Е МАQEDONISË СË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 4 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas lëndës me vet; iniciativë KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 54-të, të mbajtur më 02.11.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura pranë KSHPK-së për lëndën me numër 09-950/1 prej datës 01.03.2021, NDËRPRITET.

Kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje pranë Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit është paraqitur për personin zyrtar /// deputet i RMV-së, sepse pas zgjedhjes së funksionit, menaxhmenti i kompanisë së tij private /// i është besuar një personi të afërt, gjegjësisht djalit të tij, gjë që është në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Në bazë të nenit 45 paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit: "Personi që merr detyrën e një personi të zgjedhur ose të emëruar, me përjashtim të personave që marrin detyrën që nuk kryhet në mënyrë profesionale, nëse menaxhon një shoqëri tregtare ose institucion si pronar, është i detyruar, para se të marrë detyrën, t'ia besojë menaxhimin një personi apo organi tjetër, përveç anëtarëve të familjes së tij, gjatë ushtrimit të detyrës, autoritetet ose detyrat publike.". Në drejtim për të kontrolluar përmbushjen e këtyre obligimeve nga personat e zgjedhur dhe të emëruar, KSHPK më 12.02.2021 ka kontrolluar Sistemin e shpërndarjes së Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ka konstatuar se personi /// pasi është zgjedhur deputet i RMV-së, ka ndryshuar menaxhimin e kompanisë së tij private dhe ia ka besuar djalit të tij, përkatësisht një personi të afërt, në përputhje me nenin 8 paragrafi 4 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, në kundërshtim me nenin e lartpërmendur.

Në bazë të kësaj gjendjeje faktike, KSHPK-ja ka ngritur lëndën 09-950/1 nga 01.03.2021 kundër zyrtarit ///, deputet i RMV-së dhe në pajtim me nenin 77 paragrafi 1 të Ligjit për

Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesat kanë marrë Vendim që i është dorëzuar zyrtarit ///, me të cilin është theksuar domosdoshmëria e eliminimit të konfliktit të interesave, gjegjësisht menaxhmentit të kompanisë /// t'ia besojë një personi apo organi tjetër, përveç anëtarëve të familjes së tij.

Përkundër faktit se KSHPK-ja në disa raste ka tentuar ta informojë siç duhet zyrtarin /// për gjendjen me të cilën ka ndodhur për shkak të shkeljes së dispozitave ligjore, si dhe për nevojën e ndërmarrjes së hapave konkretë për tejkalimin e shkeljeve, por zyrtari nuk e ka pranuar postën e dërgesës dhe nuk ndërmori hapa për ta kapërcyer atë.

KSHPK-ja i është drejtuar edhe kryetarit të Kuvendit të RMV-së për ta njoftuar për gjendjen e deputetit dhe zyrtarit ndërsa njoftimin ia ka dërguar personit zyrtar dhe Kuvendit , por një përpjekje e tillë ka rezultuar e pasuksesshme.

Për sa u tha më lart, KSHPK-ja vendosi të marrë vendim me të cilin do të ndalet procedura për lëndën dhe do të dorëzojë Kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje në Komisionin për Kundërvajtje pranë Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Punoi: E.N, bashkëpunëtor
Miratoi: KN, anëtar i KSHPK - së

KOMISIONI SHTETËRORË PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
KRYETAR,
Biljana Ivanovska